

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR
“SARRIS CRUISES & LINES”

Sot me date 19/11/2018 mbeshtetur ne ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, dhe akte ligjore e nenligjore, ne cilesine e Ortakut themelues:

- **Z.KLODIAN GLLAVA**, i biri i Pilos,shtetas Shqiptare, i datëlindjes 30.11.1977, lindur në Sarande dhe banues në Rr: Mihal Grameno, Tirane, Shqipëri identifikuar me kartë indentiteti me **Nr: 028812830** dhe me nr personal **H71130018K**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike per të vepruar

Deklaroj se kam vendosur të nenshkruaj kete kontrate themelimi për krijimin e shoqërise me përgjegjesi të kufizuar (me poshte referuar si “**Shoqëria**”), me termat e mëposhtëm:

Neni 1

Emertimi

1. Shoqeria tregtare” “**SARRIS CRUISES & LINES** ” (me posht shenuar shoqeria) krijohet ne formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar me statusin e personit juridik Shqiptare. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky statut dhe nga ligjet ne fuqi.
2. Emërtimi tregtar i shoqërisë është “**SARRIS CRUISES & LINES**” **shpk**. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.
3. Emërtimi tregtar vendoset në të gjitha aktet dhe dokumentat e shoqërise në marrdhëniet me persona të tretë, si dhe në vulën zyrtare të saj.

Neni 2

Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në : “ **Rr: Mitat Hoxha, ne hyrje te Portit Detar Sarande, Zyra Nr: 7, Sarande, Albania**” . Shoqëria ushtron veprimtarine e saj në të gjithë territorin e Shqiperisë dhe jashtë saj dhe sipas parashikimeve të këtij statuti e ligjislacionit në fuqi mund të hapi në Shqipëri dhe jashtë saj,qendra, përfaqësi,filiale,degë dhe shoqeri të tjera
2. Shoqeria do të ketë website-in e saj zyrtar: www.sarris.al
3. Shoqëria do të ketë adresat e saj zyrtare për komunikimet elektronike



4. Shënjat dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të Website mund të njoftohen vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
5. Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të Shoqërisë mund të regjistrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Shoqëria fiton personalitetin juridik dhe mund të fillojë veprimtarinë e saj pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

- Ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit si Agjent Detare duke përfaqësuar pronarin operues, charteruesin e mjetit lundrues ose operuesit të transportit pa mjet lundrues për lidhjen, në emër e për llogari të tyre, të kontratave me objekt mjetet lundruese, si dhe përfaqësimin e tyre në konfliktet, që kanë lidhje me këto kontrata..
- Shërbimet e ndërmjetësimit transparent: Shoqëria për të përmbushur detyrimet e veta e kryen aktivitetin në rolin e ndërmjetësimit që vepron për llogari dhe në emër të një personi tjetër.
- Shërbime portuale pilotimi, omerxhimi dhe spedicionere
- Veprimtari të Agjentit komisioner
- Veprimtari si Agjensi turistike edhe biletari
- Ofrimin e shërbimeve të udhëtimit tokësor, detarë dhe ajëror brenda dhe jashtë vendit.
- Transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit.
- Shoqëria do të ofroj promovimin e burimeve turistike dhe kulturore, ofroj konsulence dhe do të angazhohet në veprimtari sociale në territorin e Shqipërisë, duke bashkëpunuar me eksperte shqiptare apo të huaj.
- Shoqëria, brenda kufijve ligjorë, mund të kryejë çdo operacion që lidhet me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, truallë (blerje, dhenie me qera, shitje).
- Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Te kryejë transaksione online brenda dhe jashtë vendit dhe të mirembaje dhe ofroj asistencë teknike për këto lloje sisteme duke menaxhuar të gjitha aspektet e shitjes për partneret, agjencitë dhe gjithë rrjetin e agjenteve.
- Te kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me sistemet e biletarise elektronike si dhe çdo aktivitet apo veprimtari tjetër të cilat mund të konsiderohen të dobishme, plotësuese

ose te nevojshme per realizimin e qellimeve te shoqerise, me kusht qe keto veprime apo aktivitetete te mos sjellin ndryshim themelor te objektit te veprimtarise se shoqerise.

Ky objekt veprimtarie mund të shtohet ,pakësohet apo ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar I nenshkruar eshte 100 leke (Njeqind lek) I cili perbehet nga kontribut ne para.

- 1. Ortaku Z. Klodian Pilo Gllava,** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (Njeqind LEK) që përbën 100% të kapitali themeltar të shoqërisë.

Me mjetet e shoqerise tregtare , kuptohen edhe ato objekte sende dhe të holla që do të fitohen në të ardhmen nga ushtrimi I veprimtarise tregtare të kësaj shoqërie.

Neni 6

Kuotat dhe kalimi i kuotave

Zotërimi i kuotave,mënyrat e fitimit dhe kalimi i kuotave, pjestimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, I ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 7

Administrimi

Shoqeria administrohet nga një ose nga disa administrator persona fizike, qofshin këta dhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori/et qendrojnë në postin e tyre për **5 (Pese) vjet financiare**, me mundësi për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave qe ligji apo statute i jep asamblese duke përshire delegimin kompetencave edhe persona të tjere me prokurë të posacme.

Administratori i parë i shoqërisë është **Z.PILO GLLAVA**. Shoqëria do të drejtohet, deri në datë 18.11.2023, nga Administratori me të dhënat e mëposhtëme

- **Z. Pilo Gllava**, shtetas shqiptar, lindur më 20 Maj 1953, në Vlorë dhe banues në Sarandë, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr 024576695 dhe me Nr personal F30520143U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i Pergjithshem ka te drejta perfaqesimi te plote dhe te pjesheme. Autorizohet si me poshte:

- **Z. KLODIAN GLLAVA**, i biri i Pilos, shtetas Shqiptare, i datëlindjes 30.11.1977, lindur në Sarandë, Shqipëri identifikuar me kartë indentiteti me **Nr: 028812830** dhe me nr personal **H71130018K**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar si perfaqesues i Administratorit të Pergjithshem dhe duke patur tagrat e plota të perfaqesimit.

Oraktu I vetem Klodian Gllava do të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 8 Të tjera

Shoqëria do të ushtroj aktivitetin e saj sipas legjislacionit Shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet e personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 9 Kundërshtimet


Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakeve ose një ose më shumë ortakeve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundert i nenshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 10

Ky akt themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlereshme në gjuhën Shqipe.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "SARRIS CRUISES & LINES" SHPK

Klodian Gllava

A handwritten signature in black ink, consisting of stylized, overlapping loops and lines, positioned below the printed name Klodian Gllava.